

## Fjala për jetën dhe veprimtarinë e akademik Minir Dushi

E nderuara dhe e respektuara familje e Akademik Minir Dushit,  
I nderuar kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akademik Kraja,  
E nderuara Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, znj. Nagavci,  
E nderuara Ministre e Ekonomisë, znj Rizvanolli,  
I nderuari rector I Universitetit të Prishtinës, prof. Hajrullahu  
Të nderuar akademikë,  
Të nderuar profesorë,  
Të nderuar të pranishëm

Me pikëllim shumë të thellë e marrëm lajmin se pardje, më 27 janar 2025, ndërroi jetë akademik Minir Dushi, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i cili për pesë dekada ishte pjesë e Seksionit të Shkencave të Natyrës.

Akademik Minir Dushi lindi më 1929 në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Shkollën e mesme teknike e mbaroi në Nish (1950). Studioi në Fakultetin e Xehetarisë të Beogradit, ku diplomoi në vitin 1958. Në këtë universitet doktoroi në vitin 1965, dhe ishte njëri prej shqiptarëve të parë, që ka doktoruar nga shkencat teknike në të.

Pas diplomimit, si inxhinieri i parë shqiptar, punoi në horizontet e minierës së Trepçës, ku pastaj ka drejtuar repartin e Mbushjes së boshllëqeve të krijuara nga nxjerrja e xeherorit. Ky repart ishte ndër më të rëndësishmit për prodhimin e xeherorit në Kombinatin e Trepçës. Më tutje në këtë gjigand të ekonomisë së Kosovës akademik Dushi ushtroi funksione të ndryshme udhëheqëse, në mes tjerash ishte drejtor i Institutit për zhvillimin tekniko-teknologjik të Trepçës.

Ai ishte edhe themelues dhe drejtues i disa institucioneve shkencore dhe mësimo-shkencore të Kosovës, si:

- Shkollës së Lartë Teknike në Mitrovicë e cila kishte dy seksione xehetari dhe kimi e teknologji ku profesor Miniri punoi gjatë periudhës (1961-1966)
- Institutit të Plumbit dhe të Zinkut të Kombinatis "Trepça" ku gjatë periudhës (1966-1973), në cilësinë e drejtorit të tij, mundësoi të bëhen hulumtime të detajuara të shfrytëzimit të këtyre dy elementeve kimike shumë të pranishme në xehet që nxirren në Trepçë. Në vitin 1968 u mundësua lëshimi në punë i elektrolizës së zinkut në Mitrovicë me ç'rast u arrit progresi i nevojshëm teknologjik për përpunimin e koncentrateve në Kombinatin "Trepça" me kapacitet të prodhimit të 30000 tonëve zink elektrolitik në vit.
- Akademik Minir Dushi dha një kontribut të madh në themelimin e Fakultetit të Xehetarisë dhe të Metalurgjisë fillimisht në Prishtinë (1970) e më vonë në Mitrovicë (1975-1979). Ky fakultet gjatë kohës sa në të punoi aktivisht profesor Miniri, nxorri më se 1100 inxhinierë shqiptarë të xehtarisë, gjeologjisë, metalurgjisë, teknologjisë të cilët janë kyqur pastaj në kombinatin Trepça dhe kanë luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e tij dhe të ekonomisë së Kosovës.
- Ai ndihmoi në themelimin e Institutit tekniko-shkencor të Kombinatis "Trepça" ku punoi gjatë periudhës 1978-1981.

Akademik Minir Dushi ka patur gjithashtu një veprimtari akademike shumë të pasur. Në vitin 1969 u zgjodh profesor inordinar i Fakultetit Teknik të Prishtinës. Në qershor të vitit 1975 u zgjodh profesor ordinar i Fakultetit Xehtar Metalurgjik në Mitrovicë dhe në këtë fakultet u zgjodh dekan për dy mandate.

Qysh nga themelimi i Universitetit të Prishtinës (1970) ishte zgjedhur zëvendësrektor i parë, kurse në vitin 1981 pas demonstratave të pranverës studentore u zgjodh rektor i Universitetit gjatë periudhës (1981-1983). Anëtar korrespondent i ASHAK-ut, profesor Minir Dushi u zgjodh që nga themelimi i saj, në vitin 1975, kurse në vitin 1978 u zgjodh anëtar i rregullt. Akademik Minir Dushi ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës dhe përfaqësimin e Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut gjatë po thuajse 5 dekadave. Ai ishte përherë i përfshirë në aktivitetet dhe veprimtarinë e këtij seksioni si dhe të vet Akademisë. Një kontribut të rëndësishëm akademik Minir Dushi e dha në përgatitjen e Fjalorit të Enciklopedisë së Kosovës sidomos në përgatitjen e zërave që lidhen me veprimtarinë e Kombinatit të “Trepçës” dhe përshkrimin e pasurive minerare të Kosovës.

Akademik Minir Dushi kreu edhe disa funksione shtetërore: ishte anëtar i Kryesisë së diskutime të Kosovës pas vitit 1986 dhe rreth 5 vjet ishte në krye të Bashkësisë së Institucioneve Shkencore të Kosovës. Në atë pozitë përveç koordinimit të bashkëpunimit të këtyre institucioneve shkencore ka drejtuar edhe edicionin e botimeve të më se 40 veprave shkencore të punëtorëve shkencor të këtyre institucioneve kosovare.

Opusi shkencor dhe profesional i akademik Minir Dushit arrin mbi 180 njësi bibliografike. Nga fusha e xehetarisë ka botuar 8 vepra e afro 70 punime shkencore dhe profesionale. Ka të botuara 18 libra shkencorë, 4 janë tekste universitare (tri janë në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën serbokroate), kurse 14 të tjera janë vepra të veçanta të botuara nga ASHAK, UP-ja dhe 1 nga Bashkësia e Institucioneve Shkencore të Kosovës.

Në mesin e këtyre librave të botuar po përmend: “Makinat minerare” i botuar në vitin 1975, “Makinat minerare transportuese” i botuar në vitin 1996, “Sistemet ciklike të transportit” i botuar në vitin 1999 si dhe monografitë shkencore “Trepça” i botuar në vitin 2002, “Universiteti i Kosovës” i botuar në vitin 2004, “Veprimtaria shkencore në “Trepçë” (2006), “Pasuritë minerare të Kosovës” Vëllimi I dhe II (2009), “Qymyri i Republikës së Kosovës” (2012) dhe “Boksitet e Dukagjinit” (2015).

Akademik Minir Dushi ka marrë pjesë në shumë tubime shkencore: simpoziume e konferenca shkencore në vend dhe jashtë tij.

Për rezultatet e arritura në punën e tij akademike dhe shkencore si dhe në organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë shkencore dhe arsimore në Kosovë ai është nderuar me 28 shpërblime të ndryshme, mirënjohje, diploma, pllaketa e dekorata. Ndër to nga veprimtaria shkencore veçohen Shpërblimi Krahinor i Dhjetorit, shpërblimi 7 Korriku i RS të Serbisë dhe Pllaketa e argjendtë Nikolla Teslla për të arriturat e jashtëzakonshme në punët shkencore.

Akademik Minir Dushi është shpallur qytetar nderi i dy qyteteve të Kosovës, Mitrovicës dhe i

Gjakovës.

Në 25-vjetorin e Universitetit të Prishtinës, Senati i këtij universiteti ia dha titullin “profesor emeritus”, kurse Këshilli Shkencor-Mësimor i FXM i UP në Mitrovicë në dhjetor të vitit 1996 e ka shpallur Dekan Nderi.

Senati i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), më 6 mars 2023, akademik Minir Dushit ia ndau titullin: “Doctor Honoris Causa” me motivacion: “Për kontribut në themelimin dhe ngritjen e institucioneve të arsimit të lartë në Mitrovicë si dhe zhvillimin e jetës akademike në Kosovë”.

Ishte pjesëmarrës dhe veteran i LANÇ-së dhe ishte bartës edhe i disa mirënjohjeve nga Lufta II Botërore.

Akademik Minir Dushi ka qenë kryeredaktor i revistës “Kërkime” që filloi të botohej në ASHAK që nga viti (1980) deri më 2016 kur kjo revistë u shndërrua në revistën Research/Kërkime, dhe ishte kryeredaktor i revistës Plumb-zinku të Institutit të Plumbit dhe Zinkut të kombinatit “Trepça”.

Akademik Minir Dushi ishte iniciator dhe njëri nga themeluesit e Shoqatës së Intelektualëve “Jakova” të Gjakovës (2002). Po ashtu ai ishte bashkë-themelues i Muzeut të Kristalëve në Minierën e Trepçës në Stantërg (1964).

Të nderuar të pranishëm, profesor Minir Dushi na la, por vepra e tij është pjesë e vyer e trashëgimisë akademike të Kosovës. Arritjet e tij shkencore janë e do të jenë në duart e studiuesve brenda dhe jashtë Kosovës. Ai e shkroi jetën e tij në këto arritje.

Me ndarjen nga jeta, familja e humbi prindin, gjyshin shembullor, ne e humbëm një anëtar të Akademisë me vlera shumë të veçanta si në aspektin e kontributit shkencor dhe në atë akademik e kombëtar. Megjithatë si familja e tij e respektuar e edhe ne si institucion jemi me shumë fat se do të kemi në shfrytëzim trashëgiminë e tij shkencore shumë të begatë si dhe do të jemi përherë krenar me veprën e tij.

Lavdi jetës dhe veprës së Akademik Minir Dushi!

Prishtinë, më 29 janar 2025